



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P.630/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.09.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-89015-03-04-2021, me objekt “Ndriçim rruga Hysen Myshketa 1752 m”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 14,311,000 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Agi Kons” SHPK  
*Adresa: Kodra e Diellit 2, Kompleks Hotelerie me struktura 2.3 dhe 5 kate, me dy kate nën tokë, Farkë/Tiranë.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
*Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.*

**Subjekt i interesuar:** Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK  
*Adresa: “Rruga e Kavajës”, P.114, Shk.1, K.2, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04.03.2021 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-89015-03-04-2021, me objekt “Ndriçim rruga Hysen Myshketa 1752 m”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 14,311,000 lekë pa Tvsh, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Nga verifikimet në SPE, rezulton se në datën 06.05.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- |                              |  |
|------------------------------|--|
| 1. “Eurondërtimi 2000” SHPK  | 10,989,490 lekë pa tvsh, kualifikuar;  |
| 2. “L.T.E Construction” SHPK | 13,369,700 lekë pa tvsh, skualifikuar; |
| 3. “Al-Asfalt” SHPK          | 13,474,000 lekë pa tvsh, skualifikuar; |
| 4. “Agi Kons” SHPK           | 13,794,354 lekë pa tvsh, kualifikuar;  |

II.3. Në datën 14.05.2021 operatori ekonomik “Agi Cons” SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK, me argumentet si më poshtë:

- *Në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk bazuar në dyshime të arsyeshme nuk duhet të ishte kualifikuar pasi ky i fundit nuk përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pranimi si dhe kriteret e vecanta dhe se kualifikimi i këtij të fundit është kryer në kundërshtim me nenin 46,47 dhe 53 të LPP.*

*Së pari në shtojcën 12 kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik është parashikuar se : Në momentin e hapjes së ofertave të tenderit në sistemin e APP duhet domosdoshmërisht të dorëzojnë pranë Bashkisë Durrës mostrat e mallit në zyrën e dr.Shërbimeve, kati I, pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në afatin e caktuar për dorëzimin e ofertave nga 1 copë të secilit ndriçues të përshkruar në zërin me nr.1 në preventiv (1.ndricus LED jo më të vogël se 100W, 2. ndricus LED jo më të vogël se 60W). Këto artikuj do të vihen në dispozicion të KVO brenda një kutie me emërtimin qartazi sipër emrit të operatorit ekonomik të shoqëruar me një procesverbal ku Operatori Ekonomik të ketë listuar artikujt e ofruar. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor.*

*Duke qenë se shoqëria jonë ishte vetë pjesmarrëse në procesin e dorëzimit të mostrave dhe bazuar edhe në procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për marrjen e këtyre mostrave qartësisht vumë re se mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk së bashku me të dhënat teknike sipas fragmenteve të katalogut Nordex nuk përmbushin specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor kërkon dorëzimin e 2 ndriçuesve. Në paketimin e dorëzuar nga OE Eurondërtimi 2000 shpk vëmë re që shkalla e mbrojtjes IP është ekzaktësisht siç është kërkuar në specifikimet teknike nga AK pra IP 65. Ndërkohë vëmë re që në trupin e ndriçuesve që janë sjellë si mostra nga operatori Eurondërtimi 2000 shpk shkalla e mbrojtjes nuk është IP 65 sic është paraqitur në dokumentin e firmosur e vulosur nga Eurondërtimi 2000 ku shkalla e mbrojtjes ishte sipas kërkesave të AK por në trupin e ndriçuesve që janë sjellë si mostra shkalla e mbrojtjes ishte IP 67.*

- *Së dyti në dokumentin e specifikimeve teknike të ofruara nga Eurondërtimi 2000 shpk tipi i LED të përdorur është Osram Duris P8. Specifikimet teknike të këtij LED-i që ofrohen nga skedat teknike të Osram për tipin Duris P8 tregojnë që efica e këtij modeli është 151 m/w që do të thotë për 100w ky model ofron 15100lm dhe jo 15300lm siç shkruhet në skedën teknike që ka paraqitur Eurondërtimi 2000 shpk.*
- *E njëjta gjë vlen edhe për ndriçuesin prej 60w i cili përdor po këtë tip LED pra Osram Duris P8. Pra për 60w me një efica maksimale prej 151lm/w që ka ky model LED ndriçuesi i paraqitur dhe ofertuar nga Eurondërtimi 2000 shpk mund të sigurojë një maksimum prej 9060lm dhe jo 10200lm sic kërkohet nga AK apo sic ka paraqitur në dokumentacion Eurondërtimi 2000 shpk.*
- *Së treti në dokumentin mbi specifikimet teknike kërkohet që këndi i hapjes së dritës duhet të jetë më e madhe baraz 150 gradë ndërsa në dokumentacionin e dorëzuar nga*

- operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk këndi i hapjes së dritës rezulton të jetë përcaktuar njëherë 120 gradë dhe po në këtë dokument më poshtë rezulton 155 gradë.*
- *Sa më sipër në një interpretim teknik të specifikimit teknik të mësipërm bëjmë me dije se këndi i ndricuesit nuk mund të jetë më i madh se këndi i LED-it. Pra nëse skeda Led ka një kënd prej 120 gradë atëherë rrjedhimisht ndricuesi nuk mund të ketë një kënd prej 155 gradë.*
  - *Së katërti bazuar në mostrat dhe skedat teknike të dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk na rezulton se modelet e paraqitura nga ky operator ekonomik në trupin e tyre dhe në skedat teknike shënjnë modelin VR0740 dhe modelin VR1040 dhe si kompani prodhuese të tyre shoqëria Nordex ndërkohë që pas një verifikimi të kryer në faqen ëeb të kompanisë Nordex na rezulton se nuk ekziston asnjë model ose tip ndricuesi që të ketë kodet VR0740 apo VR1040 pasi të gjithë modelet e ndricuesve rrugorë që ka kompania Nordex në faqen e tyre ëeb fillojnë me numër serial NX dhe jo me numër serial VR. Gjithashtu këto skeda teknike nuk janë të vulosura e të fimrosura nga prodhuesi dhe as operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk pasi këto skeda nuk kanë asnjë element që të vërtetojë autenticitetin e tyre. Sa më sipër kërkojmë që së pari të verifikohet vërtetësia e mostrave dhe skedave teknike të dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk si dhe përpuethshmëria e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk me specifikimet teknike të parashikuara në DT.*
  - *Gjithashtu kemi dyshime të arsyeshme që operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk bazuar edhe në dokumentat e tenderit nuk ka plotësuar me të gjitha të dhënat e kërkuara shtojcën 8 Deklartatë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme pasi nuk ka specifikuar të gjithë listën e personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit, mbikqyrësit, aksionerit, ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese vendimmarrje ose kontrolluese brenda OE. Sa më sipër kërkojmë nga AK verifikimin nëse kjo deklaratë është plotësuar duke përfshirë listën e të gjithë personave që ushtojnë këto funksione në shoqërinë Eurondërtimi 2000 shpk.*

II.4. Në datën 21.05.2021 me shkresën nr. 1668/10 prot operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.5. Në datën 28.05.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr.1668/13 prot datë 04.06.2021 protokolluar me tonën me nr.920/2 prot datë 10.06.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Agi Kons” SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK, me argumentin: [...] - *Së katërti bazuar në mostrat dhe skedat teknike të dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk na rezulton se modelet e paraqitura nga ky operator ekonomik në trupin e tyre dhe në skedat teknike shënpjnë modelin VR0740 dhe modelin VR1040 dhe si kompani prodhuese të tyre shoqëria Nordex ndërkohë që pas një verifikimi të kryer në faqen web të kompanisë Nordex na rezulton se nuk ekziston asnjë model ose tip ndricuesi që të ketë kodet VR0740 apo VR1040 pasi të gjithë modelet e ndricuesve rrugorë që ka kompania Nordex në faqen e tyre web fillojnë me numër serial NX dhe jo me numër serial VR. Gjithashtu këto skeda teknike nuk janë të vulosura e të fimbrosura nga prodhuesi dhe as operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk pasi këto skeda nuk kanë asnjë element që të vërtetojë autenticitetin e tyre.*

*Sa më sipër kërkohet që së pari të verifikohet vërtetësia e mostrave dhe skedave teknike të dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk si dhe përpuethshmëria e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik Eurondërtimi 2000 shpk me specififikimet teknike të parashikuara në DT [...]*”

III.1.1. Në shtojcën 12, pika 2.3.m “Për kapacitetin teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: *“m.Në momentin e hapjes së ofertave të tenderit në sistemin e APP duhet domosdoshmërisht të dorëzojnë pranë Bashkisë Durrës mostrat e mallit në zyrën e dr.Shërbimeve, kati I, pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në afatin e caktuar për dorëzimin e ofertave nga 1 copë të secilit ndriçues të përshkruar në zërin me nr.1 në preventiv (1.ndriçues LED jo më të vogël se 100W, 2. ndriçues LED jo më të vogël se 60W). Këto artikuj do të vihen në dispozicion të KVO brenda një kutie me emërtimin qartazi sipër emrit të operatorit ekonomik të shoqëruar me një procesverbal ku Operatori Ekonomik të ketë listuar artikujt e ofruar. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor”*


III.1.2. Ndërsa në shtojcën “Specifikimet teknike”, të ngarkuar në SPE për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

*“SPECIFIKIME TEKNIKE (Ndricim rrugor) Ky investim në këtë segment do të ketë ndërtim të ri të rrjetit të ndriçimit rrugor në një distancë prej 927ml për rrugën “Hysen Kërtusha” dhe 825ml rruga “Hysen Myshketa” në total do të jenë 1752 ml. Në këtë investim do të bëhet infrastruktura për 76 shtyllat dekorativ e ndriçimit. Shtyll cilindrike çeliku i zinguar në të nxehtë dhe e lyer me bojë elektrostatische me shkallë mbrojtjeje IP 65 për ndriçimin në rrugën “Hysen Kërtusha” që konsiston në betonime për montimin e shtyllave dhe vendosjen e 80 pusetave plastike 40x40x40 në një trup të vetëm. Dhe 37 shtyllat e ndriçimit në rrugën “Hysen Myshketa” që konsiston në betonime për montimin e shtyllave dhe vendosjen e 80 pusetave plastike 40x40x40 në një trup të vetëm. Puseta do të betonohet pas shtyllës, në shtrimin e tubit fleksibel Ø80 në një kanal 40cm të thellë, i mbuluar me shtresë rëre 10cm, sipas kushteve teknike të zbatimit. Kalimi i tubit fleksibel nga trotuari në trotuar në stresat asfaltike do të bëhet në tub celiku me d= 140mm. (shiko detajet e projektit). Do të bëhet dhe vendosja e 76 +37 shtyllave 6.5 ml me spesor 3-4mm . Shtylla dekorative me ndriçues LED me fuqi 100-110w , ≥17000Lm nga krahu i rrugës, dhe 60-70 w, ≥10200Lm nga krahu trotuarit, me temperaturë pune -25grad- +50grad celcius dhe me shkallë mbrojtjeje IP 65 me*

jetëgjatësi 100.000 orë pune. Ndriçimi në këtë investim do të ketë dy funksione, edhe si pjesë e arredimit ashtu dhe anë funksionale.

<b>SKEDA TEKNIKE</b>	
TEMPERATURA E NGJYRËS	4000-5000K
FUQIA	100-110W
LUMEN	≥ 15 300 lm
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	≥ 150°
<b>PËRSHKRIMI</b>	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHTËM
<b>STRUKTURA</b>	TRUP PREJ ALUMINI I LYER
<b>HYRJE</b>	AC 230V - 50Hz
<b>JETËGJATËSIA</b>	100'000 h

<b>TË DHËNA FOTOMETRIKE</b>	
TEMPERATURA E NGJYRËS	4000-5000K
FUQIA	60-70W
LUMEN	≥ 10 200 lm
KËNDI I HAPJES SË DRITËS	≥ 150°
<b>PËRSHKRIMI</b>	NDRIÇUES LED PËR PËRDORIM TË JASHTËM
<b>STRUKTURA</b>	TRUP PREJ ALUMINI I LYER
<b>HYRJE</b>	AC 230V - 50Hz
<b>JETËGJATËSIA</b>	100'000 h



[...]"

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.1.4. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.”*

III.1.5. Në nenin 26 pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.”*

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kërkesat e autoritetit kontraktor në lidhje me mostrën e artikujve në shtojcën “Specifikime teknike”, në rastin konkret nuk janë elemente lehtësisht të dallueshme, të verifikueshme dhe të matshme, për këtë arsye, për të vërtetuar nëse mostrat e paraqitura plotësojnë specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor është e nevojshme paraqitja e një skede teknike apo katalogu autentik të lëshuar nga prodhuesi produktit (mostrës). Në kushtet kur, nga një operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me anë të ankesës në KPP, ngre pretendime mbi origjinalitetin e produkteve (mostrave) të ofruara dhe skedës teknike që i shoqëron këto produkte (mostra), Komisioni gjykon se mënyra më e mire, për të vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe transparente pretendimet ankimesit, është verifikimi i origjinalitetit produkteve (mostrave) të ofruara dhe skedës teknike, duke komunikuar drejtëpërdrejtë me prodhuesin përkatës për arsye konfirmimi.



III.1.8. Komisioni konstaton se operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, ka paraqitur mostrat për ndriçuesit LED jo më të vogël se 100W dhe LED jo më të vogël se 60W, të cilat kanë të ngjitur nga një etiketë ku përshkruhen specifikimet teknike të këtyre mostrave, numrat e serisë (kode) (VR1040 dhe VR0740), si dhe dallohet logo e kompanisë prodhuese “Nordex”. Gjithashtu, me mostrat e paraqitura, operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK ka paraqitur një skedë teknike në të cilën përshkruhen specifikimet teknike në tre gjuhë (Anglisht, Italisht, Shqip), të këtyre dy produkteve të paraqitura në cilësinë e mostrës.

III.1.9. Lidhur me mostrat e mësipërme, me qëllim verifikimin e origjinalitetit dhe specifikimeve teknike të tyre, në datën 02.07.2021, me anë të postës elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik i’u drejtua kompanisë prodhuese Nordex duke kërkuar nga kjo e fundit konfirmim, nëse produktet ndriçuese LED, me numrat e serisë(kode) VR1040 dhe VR0740, prodhohen nga kjo kompani dhe se cilat janë specifikimet teknike të ndriçuesve me këto numra serie. Në datën 22.07.2021, kompania prodhuese është përgjigjur me anë të postës elektronike duke konfirmuar se: *“Fatkeqësisht ne nuk i prodhojmë produktet që ju kërkonit”*.

III.1.10. Në vijim, me anë të shkresës nr. 920/5 prot., datë 23.07.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, kërkoi nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK, dokumentacion që provon se produktet me numrat e series (kode) VR1040 dhe VR0740 prodhohen nga kompania Nordex. Në datën 26.07.2021, me anë të shkresës nr. 79/1 prot., datë 26.07.2021, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 920/6 prot., datë 27..07.2021, operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK informon si më poshtë:

*“[...]Në lidhje me kërkesën tuaj Nr.920/5 Prot. “Kërkesë për dokumentacion”, ju bëjmë me dije si më poshtë: Shoqëria “Eurondërtim 2000”sh.p.k. në fazën e përgatitjes së dokumentacionit për të marrë pjesë në këtë procedurë ka vepruar saktësisht në këtë mënyrë. Në rastin konkret, për këtë procedurë ne kemi kërkuar mbështetjen e operatorit ekonomik “Elal Com” sh.p.k, si shoqëri më e specializuar në këtë fushë, e cila do të siguronte mostrat për ndriçuesit e kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, si dhe dokumentacionin teknik përkatës. Njëkohësisht, me një marrëveshje paraprakisht verbale, do të realizonte edhe furnizimin dhe montimin e punimeve elektrike për këtë objekt, përfshirë ndriçuesit e paraqitur me anë të mostrave. Kjo marrëveshje verbale, do të formalizohej shkresërisht në një marrëveshje Furnizimi dhe Shërbimi mes palëve për këtë objekt, nëse “Eurondërtim 2000” sh.p.k. do të shpallej fitues në këtë procedurë. Menjëherë pas marrjes së shkresës suaj ne kemi vënë në dijeni dhe kemi kërkuar nga partneri ynë “Elal Com” sh.p.k të provojë vërtetësinë e dokumentacionit, objekt i shkresës suaj Nr. 920/5 Prot. Datë 23.07.2021. Kontakti dhe komunikimi me kompaninë prodhuese “Nordex” në emrin tonë në këtë rast është kryer nga shoqëria “Elal Com” sh.p.k.*

*Në lidhje për sa më lart ne po ju bashkëngjisim edhe korrespondencën e shoqërisë “Eurondertim 2000” shpk me shoqërinë “Elal com” sh.p.k, si dhe deklaratën e firmës prodhuese mbi modelet e ndriçuesve të paraqitur [...]”*

III.1.11. Komisioni konstaton se bashkëlidhur me shkresën e dërguar nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK, është paraqitur një deklaratë në gjuhën italiane, e cila është përkthyer në gjuhën shqipe dhe është shoqëruar me vërtetim përkthimi nga noteri. Në këtë deklaratë deklarohet si më poshtë:

*“Me anë të këtij dokumenti deklarohet se trupat ndriçues VR0740 dhe VR1040, kanë qenë produkte që i kemi prodhuar ne deri në dhjetor 2020. Që prej dhjetorit 2021 kemi futur një*

*linjë të re të trupave rrugore ndriçues, me qëllim që t'i përgjigjemi kërkesës në rritje të standardeve të efikasitetit të cilat diktohen nga tregu. Për këtë arsye, prodhime të ngjashme me ato të sipërpërmendura, mund të jenë:*

*- SPRING LED 60W DHE 120W*

*- OPTIMUS 2 LED Ndriçues rruge prej 90W deri në 100W.*

*Për informacione të mëtejshme ju lutemi të kontaktoni me kompaninë Elal Com shpk, dmth bashkëpunëtorin tonë kryesor në tregun shqiptar”.*

III.1.12. Sa më sipër, nisur nga konfuzioni i krijuar nga deklaratet kontradiktore të kompanisë prodhuese Nordex, ku në komunikimin e drejtëpërdrejtë me KPP, kjo kompani deklaroi se nuk i prodhon produktet me numra serie (kode) VR1040 dhe VR0740, ndërsa në deklaratën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK, me anë të shkresës nr. 79/1 prot., datë 26.07.2021, deklaroi se dikur i prodhonte, por nga viti 2020 nuk i prodhon më, Komisioni gjykoi t'i drejtohej edhe një herë kompanisë prodhuese Nordex me anë të potës elektronike në datën 28.07.2021, duke kërkuar përsëri konfirmim nga kjo e fundit nëse produktet me numra serie (kode) VR1040 dhe VR0740 janë prodhuar ndonjëherë nga kompania Nordex; Në rast se po, deri kur janë prodhuar; Nëse kompania Nordex furnizon tregun ende me këto produkte edhe pse ka ndërprerë prodhimin e tyre; Cilat janë specifikimet teknike të këtyre produkteve, si dhe nëse deklarata e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK me anë të shkresës nr. 79/1 prot., datë 26.07.2021 është lëshuar realisht nga kompania Nordex. Lidhur me këtë kërkesë për konfirmim të Komisionit të Prokurimit Publik, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme dhe insistimit nga ana e KPP-së, kompania prodhuese nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

III.1.13. Sa më sipër, në kushtet e konfuzionit të krijuar për shkak të deklaratave kontradiktore të paraqitura nga ana kompanisë prodhuese Nordex, mungesës së përgjegjësisë të treguar nga kjo kompani prodhuese për të mbështetur ofertuesit e mundshëm të produkteve të saj duke mos kthyer përgjigje ndaj kërkesave të vazhdueshme për verifikim të Komisionit të Prokurimit Publik, moscilësimi i personit që ka nënshkruar deklaratën e kompanisë prodhuese Nordex të paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK me anë të shkresës nr. 79/1 prot., datë 26.07.2021, Komisioni gjykon se krijohet dyshimi i arsyeshem mbi orgjinalitetin e produkteve të paraqitura në cilësinë e mostrës, si dhe mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. KPP thekson se mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në këto kushte, Komisioni gjykon se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK për ndriçuesit LED jo më të vogël se 100W dhe LED jo më të vogël se 60W, nuk krijojnë bindjen e nevojshme mbi orgjinalitetin e tyre dhe përpuethshmërinë me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi për verifikimin e specifikimeve teknike kompania prodhuese nuk i dërgoi asnjëherë skedat teknike të produkteve edhe pse Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi në vazhdimësi ato. Komisioni vlerëson të theksojë se, referuar legjislacionit për prokurimin publik, është barrë e operatorit ekonomik ofertues që të krijojë bindjen e nevojshme se disponon kapacitetet e nevojshme për të zbatuar kontratën në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Agi Kons” SHPK qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Agi Kons” SHPK për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Agi Kons” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-89015-03-04-2021, me objekt “*Ndriçim rruga Hysen Myshketa 1752 m*”, me Fond limit/Vlera e pritshme e kontratës 14,311,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 06.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Eurondërtimi 2000” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Agi Kons” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 920 protokoli Datë 28.05.2021;**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**